



***Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.***

***Ofertë
Kryerja e shërbimeve të pagesave përmes agjentëve të
jashtëm***

I/E nderuar,

Ndihemi të privilegjuar që kemi mundësinë të ju ofrojmë ofertën e mëposhtme për një shërbim të ri që ofron Ndërmarrja Publike Posta e Kosovës Sh.A.

Prioritet i Postës së Kosovës është ofrimi i shërbimeve sa më cilësore, sa më të shpejta dhe sa më afër qytetarëve. Posta e Kosovës Sh.A. në kuadër të shërbimeve të veta e ka edhe shërbimin e pagesave. Ne jemi të licencuar për shërbimin financiar jobankar nga BQK dhe jemi lider sa i përket numrit të pagesave në tregun që mbulojnë IFJB-të. Përmes licences tone jemi te interesuar qe operatoreve te ndryshem ekonomik tu ofrojë mundesinë e shfrytëzimit te licences se PK Sh.A. per te kryer pagesa te ndryshme ne zyret e juaja.

Ne kemi përvojë të gjatë të bashkëpunimit me institucione të ndryshme të qeverisë së Kosovës, por gjithashtu edhe me kompani të ndryshme publike dhe private, me banka komerciale, etj.

Posta e Kosovës Sh.A.
Adresa: Rruga 28 Nëntori, Nr.4 Dardania,10000 Prishtinë
<http://www.postakosoves.com/>
Tel: +381 (038) 534 779
bedri.elezaj@postakosoves.com

Kushtet dhe kriteret e PK Sh.a. për dhënien e liqencës për shërbimin e pagesave për agjentët e jashtëm

Kushtet për licencim janë të parapara me ligj dhe rregulloret e BQK-së;

- Pala e tretë obligohet ti plotësoj kushtet për zyre krahas kërkesave nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës, që zyret të jenë të pajisura me kompjuter, arkë, dhe kamera.
- Operatori ekonomik të ketë biznes të regjistruar,
- Të ketë të deklaruar minimum 5,000 euro qarkullim në bazë vjetore,
- Të bëjë garancionin bankar në vlerë prej 5000 eurove,
- Të ketë minimum 5 vite përvojë pune në biznes,
- Hapësira e ushtrimit të veprimtarisë së agjentit duhet të jetë e ndarë fizikisht nga aktivitetet e tjera komerciale.
- Për hapjen e një zyre shtesë me agjent, bartja e kostove të licencimit dhe shpenzimeve tjera siç janë: qiratë, shpenzimet komunale, pagat dhe taksat i takojnë të licencuarit.
- Detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate janë: kryesi i shërbimit të IFJB-së/agjenti do të kryej shërbimet e IFJB-së për llogarinë e PK Sh.A, si agjent i jashtëm kontraktues dhe me përqindje prej 50% në emër të provizionit neto të fitimit.

Procedura e raportimit:

1. Raportimi të bëhet në baza ditore (në fund të orarit, maksimumi të nesërmen deri në ora 10:00).
2. Afatet dhe kushtet e pagesës do të jenë konform negociatave të zhvilluara.

Duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj, presim përgjigjen tuaj!

Ju urojmë punë të mbarë dhe suksese të mëtejme!

Posta e Kosovës gjithmonë në shërbimin tuaj!

Posta e Kosovës Sh.A.
Adresa: Rruga 28 Nëntori, Nr.4 Dardania,10000 Prishtinë
<http://www.postakosoves.com/>
Tel: +381 (038) 534 779
bedri.elezaj@postakosoves.com